



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr. Regj.24382/12

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtarja Lindita Jakupi me pjesëmarrjen e sek.juridike Iqrame Aliu, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kunder Bedri Mustafa Zëvendës kryesues i Kuvendi Komunal Fushë Kosovë, për kundërvajtje nga neni 5.6 paragrafi 1.2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë personat Zyrtarë, e në bazë të nenit 73,74,195,198 al.l. pika 10 të LMK, me datën 08.08.2012, merrë këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër Bedri Mustafa Zëvendës kryesues i Kuvendit Komunal Fushë Kosovë, për kundërvajtje nga neni 5.6 paragrafi 1.2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë, konform nenit 198 al.l.pika 10 të LMK, pasi ushtruesi i kërkesës ka hequr dorë nga kërkesa.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të lartëpërmendurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

AGJENCIA KUNDËR KORRUPCIONIT PRISHTINË, parashtroi kërkesën nr 01-2184/2012 të dt.28.06.2012 ndaj të lartëpërmendurit për kundërvajtje nga neni 5.6 paragrafi 1.2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtarëve të Lartë[Publikë dhe Deklarimin, Prjeardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë. Pasi që ushtruesi i kërkesës ka terhequr kërkesën, Gjyqtarja konform nenit 198 al.l.pika 10. të Ligjit mbi kundërvajtje PEZULLOI procedurën kundërvajtëse kundër të lartëpërmendurit, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, brenda 8 ditësh pas marrjes së të njejtit dhe pa taksa.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJYQTARJA

Lindita Jakupi



REPUBLIKA E KOSOVËS		REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPCIONIT PRISHTINË		AGENCY FOR ANTI-CORRUPTION PRISHTINE	
Dep.	DPK / DHP	Nr Prot	03-2942/12
Dep.		Br Prot	
Dep.		Prot No	
Nr. i ftoq		Data	22.08.2012
Broj. stranica	01	Datum	
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			